



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË FIER

Nr. 13329/12 Prot.

Fier më 26/12/2024

VENDIM

NR. 143 Dt. 23/12/2024

“Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr.69, datë.30.06.2023 “Për miratimin e Komisionit të Strehimit.”

Këshillit të Bashkisë Fier, sot më dt. ____/____/2024, i paraqitet për shqyrtim, materiali nga Drejtoria Juridike, Bashkia Fier në zbatim të nenit 8 pika1, 2, neni 9 pika1.1/b, të Ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar , Ligjit Nr.22/2018 “Për strehimin social”,i ndryshuar, VKM Nr.384 datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutur strehim sipas çdo programi social, të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, neni 54, gërma “k”. Këshilli i Bashkisë, bazuar në sa më sipër,

VENDOSI:

1. Të bëhet ndryshimi në pikën 1 të Vendimit të Këshillit të Bashkisë Nr.69, datë.30.06.2023“Për miratimin e komisionit të strehimit”, të përfaqësuesit të Drejtorisë Juridike, me cilësinë e anëtarit në këtë komision **znj.Jonida Tolli**, për shkak të kalimit në një drejtori tjetër me znj.**Denisa Azizaj** SNL Drejtoria Juridike, si dhe **znj.Eleni Gjikonaj** për arsye të kalimit në një detyrë tjetër me **znj.Pranvera Çina**.
2. Bashkia Fier, Komisioni i Strehimit dhe Këshilli i Bashkisë do të kryejnë procedurat për programet sociale të strehimit, konform ligjit Nr.22/2018 “Për strehimin Social” i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.
3. Ngarkohet për zbatimin e mëtejshëm të procedurave administrative ligjore ekzekutivi i Bashkisë Fier.
4. Ky vendimi hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI I KËSHILLIT
ANTONETA CUNAJ

